



Prishtinë, 10.07.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2792_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2682_04_25** i datës 10.04.2025;
- Ankesa e konsumatorit e datës 08.05.2025.

në seancën e mbajtur më datë 10.07.2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit M. P., nga Komuna e Prishtinës, si e pabazuar.
- II. **MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2682_04_25 i datës 10.04.2025.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 10.04.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2682_04_25 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e konsumatorit M. P., lidhur me kontestimin e faturimit me njehtsorin elektrik me nr. 87438955.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori M. P., brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Objekti në fjalë është i pabanuar dhe nuk i plotëson kushtet për banim dhe se faturimi është i paarsyeshëm;
- Kërkon nga Bordi shqyrtim të hollësishëm të rastit;

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 08.05.2025; Vendimin e DMK të datës 10.04.2025; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës



14.12.2024; Përgjigjen e KESCO-s të datës 09.01.2025, Ankesën e konsumatorit në DMK të ZRrE-së të datës 21.01.2025; Fotografitë e dërguara nga konsumatorja; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0012777 i dt. 11.03.2025; Raporti i Verifikimit nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës – MINT, i dt. 25.03.2025; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e Energjisë Elektrike dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Me datë 26.11.2024, Departamenti i Faturimit në KESCO i ka dërguar konsumatorit faturën me nr. 11240DPR-90179310, në vlerë prej 179.34 €. Me datë 14.12.2024, konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO duke e kundërshtuar këtë faturë, nën dyshimet për matje jo të saktë të energjisë elektrike me njehsorin me nr. 87438955. Pas shqyrtimit dhe analizimit të ankesës së konsumatorit, Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO, lëshon një Vendim, me të cilin refuzohet ankesa e konsumatorit, dhe atë duke u bazuar në leximet e rregullta mujore, rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve.

Me datë 21.01.2025, i pakënaqur me këtë Përgjigje, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, duke e kontestuar në tërësi faturën 11/2024 si dhe faturimin me njehsorin elektrik nr.87438955 për shkak të faktit se në banesë nuk jeton askush. Konsumatori i propozon DMK-së që ankesa të aprovohet, ashtu që faturat e kontestuar të anulohen në tërësi.

Bordi ka analizuar transaksionet e konsumatorit dhe konstaton se konsumatori me datë 01.09.2023 është faturuar me faturën nr. 111-DPR23S505664 për taksa/shërbime lidhje e re në vlerë 23.60€ si dhe i është hapur shifra DPR-90179310.

Bordi po ashtu ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe listat e leximit dhe konstaton se konsumatori ka lexime të rregullta mujore, dhe se lexuesi i KEDS-it në asnjë rast nuk ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e shpenzimeve mujore. Bazuar në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike dhe transaksioneve vërtetohet se konsumatori nga periudha 09/2023 deri në periudhën 08/2024 është faturuar pa shpenzime, vetëm me taksa fikse, kurse për periudhën 09/2024 deri në periudhën 12/2024 është faturuar me shpenzime mujore kurse nga periudha 01/2025 e tutje ka vazhduar të faturohet me taksa fikse pa shpenzime.

Duke e pasur parasysh ankesën e konsumatorit se banesa është e pabanueshme dhe se nuk ka shpenzim të energjisë elektrike dhe se dyshon në matje dhe faturim jo të saktë, me datë 10.03.2025 ka kërkuar nga KEDS që të bëhet inspektimi i pikës matëse përfshirë edhe instalimin. Me datë 12.03.2025 ka pranuar përgjigjen nga KESCO që është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik të konsumatorit si dhe ka ofruar procesverbalin e ndërrimit me nr. 0012777 të datës 11.03.2025. Bordi e ka shqyrtuar procesverbalin me nr. 0012777 të datës 11.03.2025 dhe konstaton se ekipet e KEDS-it të autorizuar për ndërrim njehsori kanë larguar nga matja njehsorin nr. 87438955 me gjendje TL=002137 kWh dhe TU=001459 kWh si dhe kanë vendosur për matje njehsorin nr. 86107890 me gjendje të shpenzimeve TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Po ashtu ekipi i KEDS-it ka evidentuar vërejtjen se: *"Me urdhëresë të menaxhmentit bëjmë ndërrimin e njehsorit sepse dyshojmë në matje jo të saktë. Njehsori*



paraparak merret futet ne qese, pllombohet dhe dërgohet ne Q.V.K. njehsori ka qenë dhe mbetet i shkyçur nga rrjeti elektrik". Sipas te dhënave te evidentuara nga ekipet e KEDS, vërtetohet se gjendja e faturuar ne periudhën dhjetor 2024, përputhët me gjendjen e shpenzimeve te evidentuara ne procesverbal.

Bordi ka gjetur se, duke pasur parasysh procesverbalin nr. 0012777 te datës 11.03.2025 dhe evidentimet e bëra nga ekipi i KEDS-it, DMK me date 12.03.2025 ka kërkuar nga KEDS që të bëjë shqyrtimin e saktësisë së matjes. Me datë 27.03.2025, ZRrE i ka pranuar nga KESCO, raportin e shqyrtimit/verifikimit të jashtëzakonshëm nr. 535/15 të datës 25.03.2025 të bërë nga Agjencia e Metrologjisë së Kosovës-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me te cilin vërtetohet se njehsori elektrik është brenda kufijve te lejuar te saktësisë së matjes.

Bazuar në shqyrtimin e faturës kontestuese, rrjedhës se energjisë elektrike, listave te leximit konstaton se KESCO me rastin e faturimit te konsumatorit per shpenzimet e periudhës kontestuese si dhe per te gjitha periudhat e faturimit ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji e ku thuhet se: 1. *Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar edhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit.*

Tutje, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, *"të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRrE-ja"*, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i shqyrtoi edhe provat e tjera materiale të prezantuara nga konsumatori, por që, si të tilla nuk kanë pasur ndikim në vendosjen ndryshe lidhur me këtë rast, andaj, nuk do të lëshohet në shqyrtim dhe elaborim të mëtejme të tyre.

Bordi i ZRRE pas analizave të bëra dëshmime dhe argumenteve të paraqitura nga palët si dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullën për Shkyçjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë, transaksionet e konsumatorit, Listat e leximit, Rrjedhën e energjisë elektrike, si dhe dokumentet e tjera si në shkresat e lëndës, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **M. P.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.